

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sikagard® WallCoat N

VESHJE EPOKSIDE ME 2 PËRBËRËS DHE ME BAZË UJI PËR IZOLIME



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard® WallCoat N është veshje rrëshire epokside me 2 përbërës, bazë uji dhe me ngjyrë për izolime.

### PËRDORIMET

Sikagard® WallCoat N duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

- Aplikim mbi beton dhe nënshtresa çimentoje
- Veshje izoluese me ngjyrë për sipërfaqe muri në mjedise të brendshme
- I përshtatshëm për dhoma me higjienë të lartë
- I përshtatshëm për mjedise prodhimi të industrisë së ushqimit dhe pijeve, vende parkimi automjetesh, zona magazinimi dhe logjistike

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Pa tretës
- Rezistencë e mirë kimike dhe mekanike
- I papërshkueshëm nga avujt e ujit
- Pastrohet lehtë
- Rezistencë e lartë ndaj karbonimit
- Vetë të shkëlqyera dekontaminimi
- Mbulim i mirë
- Pa erë
- Përzierje dhe aplikim i lehtë

### INFORMACIONE MBI MJEDISIN

Sipas klasifikimit USGBC LEED Sikagard® WallCoat N plotëson kërkesat e LEED EQ Credit 4.2: Materiale me emetime të ulëta: Bojëra & veshje SCAQMD Metoda 304-91 Përmbajtja VOC < 100g/l.

### MIRATIME / STANDARDE

- Veshje për mbrojtje të betonit sipas kërkesave të EN 1505-2/2004, DoP 0208070300100000021008, certifikuar nga Organi i Njoftuar FPC dhe mbart markën CE
- Instituti Fraunhofer, IPA, raport testimi SI 1103-544, matja e rezistencës biologjike sipas ISO 846, maj 2011
- Instituti Fraunhofer, IPA, raport testimi SI 1103-544, vetitë për degazim sipas ISO 14644-8 ISO 16000-6, -9, -11, maj 2011
- ILF Magdeburg; Gjermani, raport Nr. 3-063/2007, Pastrimi i sipërfaqeve të kontaminuara sipas DIN 25415, maj 2007
- Bodycote, Warrington Brandhaus, raport testimi Nr. 2008-2023.1-K1, klasifikimi i reagimit ndaj zjarrit sipas EN 13501-1, nëntor 2008
- MPA Dresden, raport testimi Nr. 2008-B-1002/02, reagimi ndaj zjarrit sipas DIN 4102, pjesa 1, prill 2008

## INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshire epokside me bazë uji		
Ambalazhi	Përbërësi A	kovë 14.60 kg	
	Përbërësi B	kovë 5.40 kg	
Paraqitja / Ngjyra	RAL 7032 (pebble grey), ngjyra të tjera me porosi		
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit		
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushtë të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.		
Dendësia	Përbërësi A	~ 1.58 kg/l	(EN ISO 2811-1)
	Përbërësi B	~ 1.07 kg/l	
	Rrëshira e përzierë	~ 1.39 kg/l	
	Vlerat e dendësisë të përcaktuara në +23°C		

Përmbajtja e substancave të ngurta për ~64%  
peshë

Përmbajtja e substancave të ngurta për ~50%  
vëllim

## TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj abrazionit	94 mg (CS10/1000 cikle/100 0g)	(ASTM D 4060)
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	> 1.5 N/mm <sup>2</sup> në beton	(ISO 4624)
Rezistenca kimike	Ju lutemi kontaktoni shërbimin teknik Sika për informacione specifike.	
Rezistenca termike	<b>Ekspozimi</b>	<b>Nxehtësi e thatë</b>
	I përhershëm	+50°C
	max. 3 ditë	+80°C
	max. 12 orë	+100°C

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 73 : 27 për peshë / 65:35 për vëllim		
Konsumimi	~ 0.28 kg/m <sup>2</sup> për shtresë		
Trashësia e shtresës	~ 0.15 mm për shtresë		
Temperatura e mjedisit	+10°C deri në +40°C		
Lagështia relative e ajrit	< 75%		
Temperatura e nënshtresës	+10°C deri në +30°C ≥3°C mbi pikën e vesës, kujdes kondensimin		
Koha e punueshmërisë	<b>Temperatura</b>	<b>Koha</b>	
	+10°C	~ 150 minuta	
	+20°C	~ 90 minuta	
	+30°C	~ 60 minuta	
Koha e maturimit	<b>Temperatura</b>	<b>Min.</b>	<b>Max.</b>
	+10°C	3 orë	7 ditë
	+20°C	3 orë	7 ditë
	+30°C	2.5 orë	7 ditë

## UDHËZIME APLIKIMI

Përpara përzierjes së plotë, përzieni mekanikisht përbërësin A. Kur i gjithë përbërësi B është shtuar tek përbërësi A përzieni vazhdimisht për 3 minuta derisa të përftohet një miks homogjen. Përdorni mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300-400 rpm) për të shmangur bllokimin e ajrit. Për të siguruar përzierjen e duhur hidheni materialin në një enë të pastër dhe përzieni sërish. Aplikoni me furçë, rul ose spërkatje pa ajër.

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

Ky produkt duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë. Me lagështi relative >75% koha e mbiveshjes shtohet me 24 orë. Mos aplikoni Sikagard® WallCoat N mbi pllaka gipsi kur përdoren në zona me prani uji, p.sh. dushet. Siguroni ajrosje të mirë kur aplikoni Sikagard® WallCoat N në zona të mbyllura për të siguruar tharjen e plotë. Sikagard® WallCoat N i freskët duhet të mbrohet nga kondensimi dhe uji për të paktën 24 orë. Për përputhje të saktë ngjyrash, përdorni material nga i njëjti numër serie prodhimi.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

### UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / j lloji sb) është 140 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikagard® WallCoat N është <140 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepjen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikagard® WallCoat N

Mars 2019, Botimi 02.01

020811020030000007

SikagardWallCoatN-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf

BUILDING TRUST

